



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Fier, më \_\_\_\_/07/2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Shoqerimi i Vlerave Monetare”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbime roje/sherbime me roje

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**2,985,888 (dymilion e nenteqind e tetedhjetë e pese mijë e teteqind e tetedhjetë e tete) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Sh.a.Ujesjelles-Kanalizime” Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik**

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1.2. Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

## ➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare(2020-2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure,si dhe bazuar në **nenin 77 pika 3 i LPP**,si dhe **nenin 43pika 1 tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021** “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërëbazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

---

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancevepër vitet (2021-2022) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Ky kriter do te përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

## ➤ 2.3 Kapaciteti teknik:

Për kapacitetin teknik operatori ekonomik duhet të paraqesë:

### 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen **dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tri viteve të fundit, me një *vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është e percaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit 162/2020 "Per prokurimin publik" dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr.285, dt.19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"(e ndryshuar).*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e shërbimit të kontratës e vlefshme. Shoqëria ofertuese duhet të paraqesë licencën e shoqërisë të vlefshme për pikat dhe klasifikimin : **Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të "Transportin dhe shoqërimin i vlerave monetare", nënkategoria 1.3.B.**

***Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është e percaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe Udhëzimi nr.130 dt.05.03.2018 Kreu VI pika C / 1. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kërkesa e disponimit të një license të tillë të lëshuar nga ana e organeve kompetente është e lidhur ngushtesisht me tipologjinë e shërbimit të kerkuar objekt kontrate Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.*

**2.3.3.** Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Certifikatë të Titullarit të subjektit të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e veprimtarisë së aktivitetit për kategorinë 1.3 B, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij).

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është e percaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në nenin 14/b të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

*(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Ky kriter shërben për të garantuar AK-në se OE ofertues, janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.*

**2.3.4.** Certifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në baze të Ligjit nr. 75/2014, nënkategoria I.3.B, për të paktën për jo më pak se 4 (kater) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Fier;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Ky kriter shërben për të garantuar AK-në se OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.*

**2.3.5** Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Certifikatë e Drejtuesit Teknik e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e veprimtarisë aktivitetit kategoria 1.3 B, lëshuar nga Dr. e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në baze të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*Ky kriter shërben për të garantuar AK-në se OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.*

**2.3.6** Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Licensë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” për vitin 2021, me fushe mbulimi në qarkun ose qytetet ku do të kryhet veprimtaria.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në pikën D. Qendra e Kontrollit, të Kreut VII, Uniformat, mjetet, pajisjet e shërbimit, dokumenti I identifikimit të punonjësve të SHPSF-SË, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë

të Brendshem dhe në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuenca vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponoje te pakten 4 (kater) automjete te blinduar Për transportine vlerave monetare, me norme blindimi jo me te ulet se BR 3 , mjete te cilat duhet te jenë ne pronesi te Operatorit ekonomik ose me qera. Për te vertetuar kete Operatori ekonomik duhet te paraqese:

- a) Lejet e qarkullimit dhe certifikat pronesie nga Drejtoria e Transportit Rrugor
- b) Certifikate e Kontrollit Teknik Për secilin mjet (SGS).
- c) Siguracion te vlefshem për secilin mjet,
- d) akt kolaudimi te vlefshem për secilin mjet

**Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshem.

**Konkretisht:** Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi, në pjesën e dytë të ditës për grumbullimin e parave të arkëtuara nga shërbimet financiare të realizuara.

**Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.**

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të disponoje 4 (kater) Autorizime të vlefshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve të blinduara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, gërma B), pika 5, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshëm.

**Konkretisht:** Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi është parashikuar disponimi i 2 autorizimeve për automjetet e blinduara që do të ofrojnë shërbimin objekt kontrate.

*Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.*

**2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 4 (kater ) shofer për drejtimin e mjeteve të blinduara emrat e të cileve të figurojnë tek Autorizimet e Mjeteve të blinduara të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në Përputhje me numrin e mjeteve të blinduara të kerkuara.

**Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, pika 1. Kategori A:, germa b), të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

*Konkretisht: Për vetë rendësinë që ka realizimi i këti lloji shërbimi me operatorë të licencuar, referuar specifikimeve teknike, numrit të prekjeve sipas qarqeve, vlerave të konsiderueshme që transportohen kryesisht nga bankat në drejtim të zyrave postare, si dhe shtrirjes në gjithë republikën, është përcaktuar edhe numri i automjeteve dhe i autorizimeve të shoferave për automjetet e blinduara që do të ofrojnë shërbimin objekt kontrate.*

*Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.*

**2.3.10** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim përformance 1.3.B të **3(tre) muajve të fundit**, nga Drejtoritë e Policisë së Qarkut ku të kete punonjës të certifikuar në kategorinë 1.3.B. Keto vërtetime duhet të Përmbajne informacionin dhe opinionin që disponon DPQ-et sa me poshte Për: -Qendra e kontrollit të Shërbimeve (salle Operative) Te mos kete marre mase administrative për (Operatorin ekonomik, Titullar dhe drejtues Teknik).

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi, ku në varësi të sasisë së vlerave monetare që do të transportohen dhe sipas normës së automjetit të blinduar është parashikuar edhe mbulimi me këtë numër punonjësish, referuar në KREU I,

*Procedurat për licencim, certifikim dhe ricertifikim të subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.*

*Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.*

**2.3.11.** Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, leshuar nga Drejtorite e Vendore të Policisë ku ndodhen objektet ku kryhet shërbimi, në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin Privat të sigurisë fizike" dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr.130, datë 05.03.2018 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë".

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika D. Qendra e Kontrollit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme, ku në pikën 5.

*Parashikohet: Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve.*

**Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën**

**2.3.12** Me qëllim parandalimin e veprimeve kriminale Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kapacitete si me poshtë :

- Për Qarkun Fier fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 4 cope GPS;  
4 cope DVR, 4 kamera dhe 4 armë zjarri

**2.3.13** Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara elektronikisht nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 6 punonjës të siguruar në muaj, ku janë 4 punonjës shërbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

**Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".**

**2.3.14** Operatori Ekonomik për të vërtetuar faktin e pronësive të armëve duhet të disponojë gjithashtu dhe dokumentacionin si me poshtë:

- Autorizim nga drejtoria e Përgjithshme e policisë Për blerjen e armëve të zjarrit
- Kontrate Shitblerje Armë me një shoqëri të licensuar ose Fature tatimore Për blerjen e armëve

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika B. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit, pika 3, dhe germa D. Qendra e Kontrollit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

*Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.*

## **REFERENCAT TEKNIKE**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

<b>Numri i Vendrojeve</b>	<b>Numri i turneve</b>	<b>Numri i rojeve te nevojshme</b>	<b>Afati i levrimit</b>
<b>Shoqerim vlera monetare</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>12 muaj</b> <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat 12 muaj.</i>

- **Shpërndarja dhe vend i shërbimit:** Shërbimi i shoqerimit te vlerave monetare do te kryhet nga Grupi i Shoqerimit (Eskorta), ne Arkat sipas tabelës se mëposhteme :

Arka Qender prane UKF
Arka ne lagjen “29 Nentori”(ISSH)
Arka ne lagjen “Apollonia” (Gjendja Civile)
Arkat Patos - Roskovec
Arkat Mallakaster

**Ky numer I rojeve te vlerave monetare eshte bazuar sipas udhëzimit Nr. 130, datë 5.3.2018 ” Për Funkionimin E Shërbimit Privat Të Sigurisë Fizike”, Kreu VI “Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të sektorit bankar, sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit” pika B. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit.**

- Grupi i shoqerimit te vlerave monetare te SHPRSF-se duhet te jete i perbere nga punonjes te certifikuar ne Nenkategorine 1.3.B sipas parashikimeve te Kreut VI pika C per shoqërimin e vlerave monetare. Keta punonjes duhet te jene te pajisur me mjete mbrojtese, uniforme dhe dokument identifikimi sic parashikohet ne Ligjin Nr.75/2014 ”Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” dhe



Udhezimin Nr. 130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem botuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018 .

- Ky Grup duhet te shoqeroje vlerat monetare qe i jane besuar dhe te siguroje jeten e personelit gjate transportit te vlerave monetare. Detyra e tij funksionale eshte Shoqerimi i sigurte i punonjesve (arketareve) te Autoriteti Kontraktor drejt filialeve te Bankave respektive sipas zgjedhjes se Autoritetit Kontraktor.
- Punonjesi i Autoriteti Kontraktor (arketari/rja) duhet te shoqerohet nga roje te armatosura.
- Per transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme sipas percaktimeve ligjore te Ligjit Nr.75 /2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike".
- Shoqerimi duhet te kryhet nga nje mjet i Operatorit Ekonomik. Mjeti duhet te jete i blinduar, i loguar ne gjendje te rregullt teknike dhe dokumentare qe te kryeje shoqerimin e vlerave monetare. Automjetet qe transportojne vlere monetare ndalohet qe te vendosin ne to dhe te perdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.
- Shoqerimi i vlerave monetare do te kryhet nje ose dy here ne dite sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar dhe ne zbatim te plote te instruksioneve te personave pergjegjes te Autoriteti Kontraktor, me grafik sherbimi perkatesisht nga dita e hene - shtune.
- Distanca qe duhet te mbulohet nga kompania e shoqerimit, nga Arka deri ne filialin me te afert te bankes
- Koha maksimale e procesit te shoqerimit te vlerave monetare do te jete 2(dy) ore.
- Koha orare e shoqerimit të vlerave monetare do të jetë : **sipas udhezimeve te SH.R.U.K.F SH.A**
- Shoqerimi duhet të kryhet me mjete te shoqerise së shoqerimit. Mjeti duhet të jetë i blinduar, i loguar, në gjendje të rregullt teknike dhe dokumentare për kryerjen e sherbimit ruajtje dhe shoqerim të vlerave monetare.

#### **Ofruesi i Sherbimit SHPRSF duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:**

- Te jete i certifikuar nga autoritetet kompetente per ushrimin e funksionit.
- Te reflekoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme.
- Gjate gjithe kohes se sherbimit punonjesi i Shoqerise SHPRSF duhet te respektoje rregullat e brendshme te Autoritetit Kontraktor.
- Të kërkojë nga punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të Objektit.
- Punonjesi i Sherbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe te veproje gjithmone ne perputhje me instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Punonjesit e Shoqerise SHPRSF qe kryejne shoqerimin e vlerave monetare duhet te jene te pajisur me armatim sipas ligjeve ne fuqi dhe ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr.130 datë 05.03.2018 "Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike" si dhe me mjete speciale per perballimin e situatave nga sulme te mundshme me qellim grabitjen e vlerave monetare ( Jelek antiplumb, Radio, Shkop gome , hekura lidhes etj).

- Shoqëria private per te siguruar shoqerimin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesi te detyrës duhet te vere në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit; armatim personal sipas ligjit per armet, jelek antiplumb, hekura lidhes, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
- Të gjithë punonjësit e shërbimit “Per Funksonimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” të publikuar ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014 dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funksonimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike”, publikuar ne Fletoren Zyrtare date 09.03.2018.
- Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike “, punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e sherbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjesit e sherbimit duhet te zbatojne Nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike“ ku percaktohet qarte se: *“Punonjësi i Shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”*.
- Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do te përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqerimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet te përcaktoje rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje me ruajtjen e objektit, personit apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje, si dhe te përpiloje plandislokimin për çdo objekt së bashku me skemat e ruajtjes dhe plane të veçanta ruajtje për situata emergjente. Ai do te jete përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do te siguroje bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

## TERMAT E REFERENCËS

### **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Sherbimi i shoqerimit te vlerave monetare”**

- Kontraktori ka për detyrë:
- Cdo punonjes i Sherbimit, Titullari i Subjektit te SHPSF-se, si dhe Drejtuesi Teknik duhet te kryejne me pergjegjesi te gjitha detyrat e percaktuara ne Ligjin Nr.75/2014 “Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike” te publikuara ne Fletoren Zyrtare date 08.08.2014, si dhe ne Aktet Nenligjore te dala ne zbatim te tij.
- Ruajtja dhe shoqërimi i vlerave monetare të mbledhura nga Arkat do të bëhet çdo ditë nga e Hëna në të **shtune**, nga vendndodhja e Arkave deri në bankat respektive.
- Kontraktori do të sigurojë ruajtjen fizike të punonjësve të arkave gjatë transportit të vlerave monetare deri në përfundim të dorezimit të këtyre vlerave pranë bankave respektive.
- Shoqerimi i vlerave monetare do te kryhet **nje here ne dite (ne situata te paparashikura/ dhe** sipas udhezimeve te SH.R.U.K.F sha.).
- Distanca qe duhet te mbulohet nga kompania e shoqerimit, nga knk/Arka deri ne filialin me te afert te bankes.
- Koha maksimale e procesit te shoqerimit te vlerave monetare do te jetë 2(dy) ore / ne varesi te rrethanave. Koha orare e shoqerimit të vlerave monetare do të jetë sipas udhezimeve te SH.R.U.K.F.sha.
- Sherbimi i shoqerimit te vlerave monetare do te kryhet **me 1 Grupe Shoqerimi** (Eskorta). Grupi i Shoqerimit do te paraqiten prane Arkes (sipas Grafikut qe do te jepet nga SH.R.U.K.Fier) ne oren sipas udhezimeve te **Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime SH.A Fier**.
- Kohezgatja e Sherbimit perfshine :
  1. paraqitjen e Grupeve te Shoqerimit ne orarin e percaktuar,
  2. pritja e perfundimit nga arketaret e procesit perpunimit te veprimeve te arkes,
  3. shoqerimi i arketareve nga Arka deri ne mjetin e blinduar,
  4. shoqerimi te vlerave monetare nga Arka me destinacion Deget e Bankes se nivelit te dyte,
  5. shoqerimi i arketereve nga mjete i blinduar ne degen e Bankes se nivelit te dyte dhe deri ne perfundimin e procesit te depozitimit te vlerave monetare nga arketaret ne Bank.
- Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” të publikuar ne fletoren zyrtare date 08.08.2014, Udhezimi i Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018, dhe në aktet e tjera nënligjore.
- **Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8 per ato pika te cilat mund te plotesohen me ane te Vetdeklarimit sipas Ligjit.**
- **Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, perpara lidhjes se kontrates, te gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

***NJËSIA E PROKURIMIT***

---